



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 107, Datë 19.05.2022

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË
LLOGARITJES SË TARIFËS PËR SHËRBIMIN E SISTEMIT TË DEPOZITIMIT
TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; të nenit 16, pika 1 dhe 32, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15, dhe 26, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.05.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 668/9 prot., datë 17.05.2022, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror”,

Konstatoi se:

- Metodologjia e llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror, ka si qëllim përcaktimin e kriterëve, kushteve dhe mënyrës së llogaritjes së tarifës për shërbimin e Sistemit të Depozitimit të Gazit Natyror (injektimin, depozitimin dhe tërheqjen e gazit natyror), bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente, në përputhje dhe me aktet rregullatore të miratuara nga ERE, të realizuar nga Operatori i Sistemit të Depozitimit të gazit natyror i licencuar.
- Metodologjia përcakton tarifat e shërbimit për operimin e impianteve të depozitimit të gazit natyror që do të zbatohen nga Operatorët e Sistemit të Depozitimit, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE.
- Tarifa për shërbimin e Depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit të gazit natyror, do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të argumentuara që Operatori i Sistemit të Depozitimit përdor për realizimin e aktivitetit dhe që janë në përputhje me këtë metodologji.
- Përcaktimi i tarifave sipas kësaj Draft-Metodologjie do të bazohet në parimin e kostove të drejta dhe të arsyeshme dhe në metodën e Normës së Kthimit të Pritshëm të Investimit (RoR).
- Tarifat e shërbimit të depozitimit për Operatorin e Sistemit të Depozitimit do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1 vjeçare), për periudhën e parë rregullatore, si dhe do të jenë në përputhje me periudhën rregullatore të zbatuar për operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes.

- Kjo metodologji adreson edhe aspektet proceduriale të aplikimit për përcaktimn e tarifës të depozitimit, si dhe dokumentacionin objekt i shqyrtimit nga ERE për llogaritjen e kostove të këtij shërbimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e sistemit të depozitimit të gazit natyror”
2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI